



# **YENİLİKÇİ TÜRK HAREKET PARTİSİ**

**Raportet financiare të fushatës dhe Raporti i Auditorëve të pavarur**

Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës  
3 Shkurt 2021 deri me 12 Shkurt 2021

**Përmbajtja:**

|  |      |
|--|------|
| Raport i auditorëve të Pavarur.. .....   | 3    |
| Pasqyra e Pozitës Financiare.....        | 6    |
| Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve..... | 7    |
| Informacionet e përgjithshme .....       | 8    |
| Shënimet e pasqyrave financiare.....     | 9-14 |

# **Raport i Auditorëve te pavarur**

## **Drejtuar Kryesisë se YENİLİKÇİ TÜRK HAREKET PARTİSİ**

### **Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike**

#### **Mohim i opinionit**

Ne kemi qenë të angazhuar për të audituar raportet financiare të fushatës për zgjedhjet nacionale të bashkëngjitura të Subjektit Politik “YENİLİKÇİ TÜRK HAREKET PARTİSİ ” (në vijim referuar si “Subjekti Politik” apo “RI”), të përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 12 Shkurt 2021, Pasqyra e të Hyrave dhe Shpenzimeve për periudhën 3 Shkurt 2021 deri me 12 Shkurt 2021, dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira ne faqe 6-14.

Ne nuk shprehim një opinion mbi raportet financiare te fushates të subjektit YENİLİKÇİ TÜRK HAREKET PARTİSİ . Për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në paragrafin bazat për mohim të dhënies së opinionit, ne nuk kemi qenë në gjendje të sigurojmë evidencën e nevojshme të auditimit për të fituar një bazë për një opinion të auditimit.

#### **Bazat për mohim te opinionit**

- Subjekti politik nuk i ka prezantuar drejt asetet, ekuitetin dhe detyrimet me 12 Shkurt 2021 dhe 3 Shkurt 2021 ashtu siç kërkohet me Standardet Ndërkombëtare te Kontabilitetit. Pas parasysh natyrën e shënimeve qe mban subjekti politik ne e kishim te pamundur te përcaktojmë vlerën e nevojshme te korrigjimeve me 12 Shkurt 2021 dhe 3 Shkurt 2021.
- Subjekti politik nuk ka ofruar dëshmi mbështetëse për te hyrat dhe shpenzimet e prezantuara për periudhën 3 Shkurt 2021 deri me 12 Shkurt 2021 prandaj ne nuk ishim ne gjendje te japim një opinion ne lidhje me te hyrat dhe shpenzimet e njohura ne pasqyrën e te ardhurave apo pajtueshmërinë e tyre me ligjin Nr. 04/L-212 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuara dhe plotësuara me ligjin Nr. 04/L-058
- Ashtu siç është shpalosur ne shënimin Shënimi 3: Donacionet dhe kontributet në të holla, Subjekti Politik ka pranuar donacione ne kesh përmes arkës vlerën prej 1,500.00 euro. Te hyrat e realizuara nga donacionet ne para nuk janë ne pajtim me kërkesat e përcaktuara me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 3, i cili kërkon qe te hyrat nga donacionet te realizohen përmes transaksioneve bankare, subjekti politik te hyrat i ka realizuar përmes arkës.

## **Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre te ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare**

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likujdojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë. Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

## **Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinion mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim



vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit & Conto sh.p.k

---

Elmije Osmani Shatri  
Auditor Ligjor  
18 Tetor 2023

# YENİLİKÇİ TÜRK HAREKET PARTİSİ

Pasqyrat Financiare të fushatës Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kuvendin e Kosovës  
3 Shkurt 2021 deri me 12 Shkurt 2021

## Pasqyra e Pozitës Financiare

| Pasuritë                               |         | Bilanci në fundë të periudhës | Bilanci në fillim të periudhës |
|--|---------|-------------------------------|--------------------------------|
| Pasuritë afatgjata                     | Shënimi | Shuma në Euro                 | Shuma në Euro                  |
| Toka, objektet dhe pajisjet            | 5       |                               |                                |
| Pasuritë e paprekshme                  |         |                               |                                |
| Pasuritë tjera afatgjata               |         |                               |                                |
| <b>Total pasuritë afatgjata</b>        |         |                               |                                |
| <b>Pasuritë afatshkurtra</b>           |         |                               |                                |
| Llogaritë e arkëtueshme                | 6       | 1,500.00                      | 1,500.00                       |
| Parapagimet                            |         |                               |                                |
| Paraja dhe ekuivalentët e parasë       | 7       | 0.00                          | 0.00                           |
| Pasuritë tjera afatshkurtra            |         |                               |                                |
| <b>Total pasuritë afatshkurtra</b>     |         | <b>1,500.00</b>               | <b>1,500.00</b>                |
| <b>Total pasuritë</b>                  |         | <b>1,500.00</b>               | <b>1,500.00</b>                |
| <b>Ekuiteti</b>                        |         |                               |                                |
| Fondet e akumuluar                     |         |                               |                                |
| Suficiti / (deficiti) i vitit          |         |                               |                                |
| <b>Total Ekuiteti</b>                  |         |                               |                                |
| <b>Detyrimet</b>                       |         |                               |                                |
| <b>Detyrimet afatgjata</b>             |         |                               |                                |
| Huat e pagueshme                       |         |                               |                                |
| Të hyrat e shtyra                      |         |                               |                                |
| <b>Gjithsej detyrimet afatgjata</b>    |         |                               |                                |
| <b>Detyrimet afatshkurtra</b>          |         |                               |                                |
| Llogaritë e pagueshme dhe të tjera     | 8       |                               |                                |
| Huatë e pagueshme                      |         |                               |                                |
| Detyrimet tjera afatshkurtra           | 9       | 600.00                        |                                |
| <b>Gjithsej detyrimet afatshkurtra</b> |         | <b>600.00</b>                 |                                |
| <b>Gjithsej detyrimet</b>              |         | <b>600.00</b>                 |                                |
| <b>Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet</b> |         | <b>600.00</b>                 |                                |

# YENİLİKÇİ TÜRK HAREKET PARTİSİ

Pasqyrat Financiare të fushatës Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kuvendin e Kosovës  
3 Shkurt 2021 deri me 12 Shkurt 2021

---

## Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve

|  | Shënimi  | 3 Shkurt 2021 – 12 Shkurt 2021 |
|--|----------|--------------------------------|
| <b>Të hyrat</b>                            |          |                                |
| Të hyrat nga buxheti                       |          |                                |
| Të hyrat nga anëtarësia                    |          |                                |
| Donacionet dhe kontributet në të holla     | 3        | <b>1,500.00</b>                |
| Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime | 4        |                                |
| Të hyrat tjera                             |          |                                |
| <b>Gjithsej të hyrat për vitin</b>         |          | <b>1,500.00</b>                |
| <b>Shpenzimet</b>                          |          |                                |
| Pagat dhe kompensimet                      |          | 900.00                         |
| Shpenzimet e transportit                   | 2        | 0.00                           |
| Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat  | 2        | 600.00                         |
| Blerja e mallrave                          |          | 0.00                           |
| Shpenzimet e përgjithshme                  | 2        | 0.00                           |
| Shpenzimet e ndryshme                      |          | 0.00                           |
| <b>Gjithsej shpenzimet për vitin</b>       | <b>2</b> | <b>1,500.00</b>                |
| <b>Suficiti / (deficiti) për vitin</b>     |          | <b>0.00</b>                    |

# YENİLİKÇİ TÜRK HAREKET PARTİSİ

*Shënimet për Pasqyrat Financiare të fushatës 3 Shkurt 2021 deri me 12 Shkurt 2021  
Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kuvendin e Kosovës*

---

## 1. Informata te përgjithshme

YENİLİKÇİ TÜRK HAREKET PARTİSİ

Udhëheqja: Ertan Simitci (Kryetar i partisë)

Përfaqësues i autorizuar financiar – Arda Maloku

Selia e partisë: Prizren

Pasqyrat financiare te YENİLİKÇİ TÜRK HAREKET PARTİSİ janë përgatitur sipas kërkesave te Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar.

Bazuar në nenin 19 paragrafi 2 pika 7 e Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 „Subjekti i regjistruar politik brenda pesë (5) ditëve të punës nga marrja e draft raporteve të audituara ka dorëzuar raportin e rishikuar financiar dhe shpjegimet lidhur me gabimet ose lëshimet të identifikuara nga auditorët.

Subjekti Politik mirëmban një llogari bankare aktive ne Banka Kombëtare Tregtare.

.



## YENİLİKÇİ TÜRK HAREKET PARTİSİ

Shënimet për Pasqyrat Financiare të fushatës 3 Shkurt 2021 deri me 12 Shkurt 2021  
Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kuvendin e Kosovës

### Shënimi 2: Shpenzimet

| Shpenzimet   | Shpenzimi në Euro | Pagesa në Euro | Borxhi i mbetur në Euro |
|--|-------------------|----------------|-------------------------|
| <b>Pagat dhe kompensimet</b>                                     |                   |                |                         |
| Pagat dhe kompensimet, neto                                      |                   |                |                         |
| Pagesat e vëzhguesve   | 900.00            | 900.00         | 0.00                    |
| Kontributet pensionale të punëmarrësit                           |                   |                | 0.00                    |
| Kontributet pensionale të punëdhënësit                           |                   |                | 0.00                    |
| Tatimet në të ardhura personale                                  |                   |                | 0.00                    |
| Beneficionet tjera   |                   |                | 0.00                    |
| <b>Gjithsej</b>  | <b>900.00</b>     | <b>900.00</b>  | <b>0.00</b>             |
| <b>Shpenzimet e transportit</b>                                  |                   |                |                         |
| Automjetet motorike të huazuara                                  |                   |                |                         |
| Karburantet  |                   |                |                         |
| Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksitë etj.                |                   |                |                         |
| Sigurimi dhe mirëmbajtja e veturave                              |                   |                |                         |
| Çdo shpenzim tjetër i transportit                                |                   |                |                         |
| <b>Gjithsej shpenzimet e transportit</b>                         |                   |                |                         |
| <b>Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat</b>                 |                   |                |                         |
| Lokali   | 600.00            | 600.00         | 0.00                    |
| Ushqimi  |                   |                | 0.00                    |
| Aktivitete kulturore dhe rekreative                              |                   |                | 0.00                    |
| Radio dhe spotet televizive                                      |                   |                | 0.00                    |
| Stendat e afishimit dhe reklamimet në gazeta                     |                   |                | 0.00                    |
| Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave |                   |                | 0.00                    |
| <b>Gjithsej reklamat, reprezentacioni dhe konferencat</b>        | <b>600.00</b>     | <b>600.00</b>  | <b>0.00</b>             |
| <b>Blerja e mallrave</b>   |                   |                |                         |
| Furnizimi i zyrës  |                   |                |                         |
| Pajisjet të vogla  |                   |                |                         |
| <b>Gjithsej blerja e mallrave</b>                                |                   |                |                         |
| <b>Shpenzimet e përgjithshme</b>                                 |                   |                |                         |
| Qiraja e lokalit të zyrës  |                   |                |                         |
| Telefoni, interneti dhe posta                                    |                   |                |                         |

## YENİLİKÇİ TÜRK HAREKET PARTİSİ

Shënimet për Pasqyrat Financiare të fushatës 3 Shkurt 2021 deri me 12 Shkurt 2021  
Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kuvendin e Kosovës

|  |                 |                 |             |
|--|-----------------|-----------------|-------------|
| Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)                                   |                 |                 |             |
| Gjoha dhe ndëshkime  |                 |                 |             |
| Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet në natyrë në mallra dhe shërbime |                 |                 |             |
| <b>Gjithsej shpenzimet e përgjithshme</b>  |                 |                 |             |
| <b>Shpenzimet e ndryshme</b>   |                 |                 |             |
| Mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës                                  |                 |                 |             |
| Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër                        |                 |                 |             |
| <b>Gjithsej shpenzimet e ndryshme</b>  |                 |                 |             |
| <b>Gjithsej shpenzimet</b>   | <b>1,500.00</b> | <b>1,500.00</b> | <b>0.00</b> |



# YENİLİKÇİ TÜRK HAREKET PARTİSİ

Shënimet për Pasqyrat Financiare të fushatës 3 Shkurt 2021 deri me 12 Shkurt 2021  
Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kuvendin e Kosovës

Për periudhën: 3/shkurt/2021 deri më 12/shkurt/2021

|   | Blerjet gjatë periudhës |
|---|-------------------------|
| Toka  |                         |
| Objektet                                    |                         |
| Veturat                                     |                         |
| Pajisjet e zyrës                            |                         |
| Pajisjet e tekonojgjisë informative         |                         |
| Pajisjet tjera                              |                         |
| <b>Gjithsej toka, objektet dhe pajisjet</b> | ////////////////////    |

## Shënime tjera

| Shënimi 6. Llogari të arkëtueshme      | Bilanci në fundë të periudhës<br>Shuma në Euro | Bilanci në fillim të periudhës<br>Shuma në Euro |
|--|--|---|
|  |  |   |
|  |  |   |
| <b>Gjithsej Llogarit e arkëtueshme</b> | ////////////////////                           | ////////////////////                            |

| Shënimi 7. Paraja dhe ekuivalentët e parasë      | Bilanci në fundë të periudhës<br>Shuma në Euro | Bilanci në fillim të periudhës<br>Shuma në Euro |
|--|--|---|
| Paraja në bankë                                  |  |   |
| Paraja në arkë                                   |  |   |
|  |  |   |
| <b>Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë</b> | ////////////////////                           | ////////////////////                            |

| Shënimi 8. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera | Bilanci në fundë të periudhës<br>Shuma në Euro | Bilanci në fillim të periudhës<br>Shuma në Euro |
|---|--|---|
|---|--|---|

## YENİLİKÇİ TÜRK HAREKET PARTİSİ

Shënimet për Pasqyrat Financiare të fushatës 3 Shkurt 2021 deri me 12 Shkurt 2021

Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kuvendin e Kosovës

|  |                   |                             |
|--|-------------------|-----------------------------|
|  |                   |                             |
|  |                   |                             |
|  |                   |                             |
| Llogari të pagueshme të tjera                      |                   |                             |
| <b>Gjithsej llogaritë e pagueshme dhe të tjera</b> | <b>//////////</b> | <b>////////////////////</b> |

| <b>Shënimi 9. Detyrimet tjera afatshkurtra</b> | <b>Bilanci në fundë të periudhës<br/>Shuma në Euro</b> | <b>Bilanci në fillim të periudhës<br/>Shuma në Euro</b> |
|--|--|---|
| Detyrimet për paga dhe tatime                  |  |   |
| Detyrimet për qira                             |  |   |
| Detyrimet për gjoba dhe ndëshkime              |  |   |
| Detyrime tjera afatshkurtër (huazimet)         |  |   |
| <b>Gjithsej detyrimet tjera afatshkurtra</b>   | <b>//////////</b>                                      | <b>////////////////////</b>                             |

